



BULETINI MUJOR

Janar
2026



Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, znj. Reme Xholi, zhvilloi një takim frymëzues dhe mjaft domethënës me studentët e RSU nr. 1, në një atmosferë të hapur, bashkëbiseduese dhe miqësore. Takimi u fokusua në diskutime të hapura mbi shërbimet sociale në Shqipëri, sfidat e përditshme, rolin thelbësor të specialistëve në mbështetjen e grupeve në nevojë, si dhe rëndësinë e angazhimit aktiv të të rinjve në ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe solidare.

Gjatë bashkëbisedimit, studentët patën mundësinë të ndanin mendimet, pyetjet dhe aspiratat e tyre profesionale, duke u njohur më nga afër me misionin, funksionet dhe fushat e veprimtarisë së Shërbimit Social Shtetëror. U theksua veçanërisht roli i të rinjve si faktor kyç në forcimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve sociale, si dhe nevoja për përgatitje profesionale, empati dhe angazhim qytetar.

Ky takim shënoi gjithashtu një moment të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit institucional, i cili u konkretizua me nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Shërbimit Social Shtetëror dhe RSU nr. 1. Kjo marrëveshje krijon mundësi të reja dhe konkrete për përfshirjen e studentëve në praktika profesionale, trajnime dhe aktivitete vullnetare në strukturat e SHSSH në të gjithë vendin.



Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, Shtëpia e Foshnjës Tiranë, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, organizoi një tryezë pune me aktorë kyç në çështjet që lidhen me garantimin e interesit më të lartë të fëmijës.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte diskutimi dhe analizimi i sfidave, praktikave dhe problematikave të evidentuara gjatë zbatimit të procedurave të menaxhimit të rasteve që trajtohen nga institucioni, si dhe identifikimi i mekanizmave për përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional.

Në këtë tryezë morën pjesë përfaqësues nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve – Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, maternitetet “Mbretëresha Geraldinë” dhe “Koço Gliozheni”, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Tiranë, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Durrës, Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli”.

Tryeza përfundoi me konkluzione dhe detyra konkrete, të cilat synojnë përmirësimin e praktikave dhe procedurave institucionale, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, në funksion të mbrojtjes dhe promovimit të interesit më të lartë të fëmijës.



Shërbimi Social Shtetëror

📍 Rruga e Durrësit, nr. 83, Tiranë, Shqipëri

☎ 044 54 18 21

✉ info@sherbimisocial.gov.al

🌐 www.sherbimisocial.gov.al